



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
BASHKIA ROSKOVEC  
KRYETARI

Nr. 274 Prot.

Roskovec, më 09.10.2017

URDHËR

Nr. 274 Datë 09.10.2017

*“Për  
Buxhetimin me Pjesëmarrje për buxhetin e vitit 2018, sipas programit buxhetor afatmesëm  
2018-2020”*

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 18 ; ligjit nr.68/2017  
“Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 5 , germa ç, neni 33, neni 40; si dhe të udhëzimeve të  
Ministrit të Financave për hartimin e buxhetit vjetor ,

Urdhëroji:

1. Fillimin e procesit të **buxhetimit me pjesëmarrje për vitin 2018** , për Bashkinë Roskovec, me qëllim që të rrisë pjesëmarrjen e zërit të qytetarëve përsa i përket vendimmarrjes së Bashkisë rreth buxhetit.
2. Përshirjen e të gjitha palëve të interesuara në këtë proces të bashkëmenaxhuar , e konkretisht: qytetarët, përfaqësuesit nga shoqëria civile lokale, administrata e bashkise dhe e institucioneve vartese , këshilli bashkiak, komuniteti i biznesit, kryetarët dhe kryesitë e fshatrave etj.
3. Procesi i pjesëmarrjes duhet të sigurojë që grupet e marginalizuara (qytetarë me të ardhura të ulëta, gra, të rinj, fëmijë dhe emigrantë) të jenë të përfshirë direkt në të gjitha fazat e buxhetimit me pjesëmarrje të Bashkisë Roskovec për vitin 2018.
4. Procesi do të konsistojë në zhvillimin e seancave dëgjimore publike në nivel lagjeje për të 14 (katërmbëdhjete) fshatrat nën juridiksionin e Bashkisë Roskovec dhe për qytetin Roskovec.
5. Afati për ezaurimin e këtij procesi do të jetë data **09.10.2017 – 20.11.2017**.
6. Ngarkohen njësite përkatëse të zbatojnë këtë urdhër sipas planit të veprimit të bashkëngjitur.
7. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.





REPUBLIKA E SHQIPERISE  
BASHKIA ROSKOVEC  
K R Y E T A R I

Nr. ~~21~~ Prot.

Roskovec, më 09.10.2017

-PLAN VEPRIMI-

PERIUDHA : 09.10.2017 – 20.11.2017

“PËR PROCESIN E BUXHETIMIT ME PJESËMARRJE, PËR BUXHETIN E VITIT 2018”

1) Hapi I: Komunikimi dhe ndergjegjesimi i qytetareve (9 tetor – 10 tetor)

Njoftim publik-ftese qytetareve te jene pjesemarrës në takimet e drejtpërdrejta me ta me cdo lagje. Kjo do te organizohet me ane te njoftimit public , komunikimit me qytetaret, publikimeve ne mediat lokale dhe rrjetet sociale.

Ngarkohen per zbatim:

- Koordinatori per te drejten e informimit,
- Zyra e informacionit dhe promociionit ,
- Zyra e Teknologjise se Informacionit
- Kryetaret e fshatrave .

2) Hapi 2: Ndarja e territorit në zona dhe kalendari i seancave degjimore : (9 tetor – 10 tetor)

- Administratori i Pergjithshem,
- Zevendeskrzetaret
- Administratoret e Njesive Administrative

duhet të vendosin për ndarjen e territorit te bashkise në zona, në mënyrë që secilës zonë t'i krijoje mundësi pjesëmarrje të drejtpërdrejtë në procesin e buxhetimit me pjesëmarrje. Nje zone mund te perfshije 2 ose me shume lagje. Te hartohet gjithashtu kalendari i seancave degjimore respektivisht per cdo lagje.

### **3) Hapi 3: Identifikimi i çështjeve dhe prioriteteve në komunitet (11 tetor – 27 tetor )**

Gjate seancave degjimore , qytetarët te diskutojne dhe te perzgjedhin projektet prioritare me te rendesishme qe kerkojne investim ne lagjet ku jetojne dhe ne listen e projekteve te perzgjedhura.

Gjate ketyre seancave do te votohet per nje projekt prioritar ne cdo lagje.

Gjithashtu gjate ketyre seancave do te perzgjidhet me proces votimi edhe nga nje perfaqesues lagjeje per te qene anetare ne Komisionin e Buxhetimit me Pjesemarrje (KBP) ku do te ndjeki procesin ne vazhdim per implementimin e projekteve te zgjedhura nga komuniteti si dhe monitorimin e procesit te Buxhetimit me Pjesemarrje.

#### **Ngarkohen per zbatim :**

- Administratori i Njesise perkatese Administrative/Zevendeskrzetari per bashkine Roskovec,
- Perfaqesues i drejtorise se finances,
- Perfaqesuesi i drejtorise juridike,
- Perfaqesues i drejtorise se sherbimeve,
- Perfaqesuesi i drejtorise se planifikimit te territorit
- Perfaqesuesi i sektorit te sherbimit social
- Perfaqesues i keshillit bashkiak,
- Kryetari i fshatit perkates.

### **4) Hapi 4 : Renditja çështjeve dhe problemeve të komuniteteve (30 tetor)**

Ky është një proces që përfshin Këshillin e Buxhetimit me pjesëmarrje dhe bëhet përmes një takimi të përbashkët të të gjithë përfaqësuesve të Këshillit të Buxhetimit me Pjesëmarrje , konkretisht finalizimi i listes se investimeve dhe projekteve.Grupi i punes i ve ne dispozicion KBP-se mendimet, sugjerimet dhe cdo problematike qe ka rezultuar gjate seancave degjimore.Drejtoria e Finances informon KBP-ne per limitn e fondeve qe mund te kete ne dispozicion gjate vitit pasardhes.

### **5) Hapi 5: Karvani (31 tetor-1 nentor)**

Pas aprovimit të listës finale të prioritetëve, organizohen vizitat në terren në mënyrë që përfaqësuesit e keshillit të BP të mund të vlerësojnë vetë prioritetet e identifikuar nga banorët në secilin fshat/lagje. Vizitat në terren zakonisht përfshijnë anëtarët e KBP, përfaqësues nga administratat dhe anëtarët e keshillit bashkiak. Vizitat në terren ndihmojnë pjesëmarrësit për të kuptuar se prioritetet e tjera në lagje të tjera mund të jenë më urgjente se prioritetet në lagjen e tyre. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për ndërtimin e konsensusit.

**6) Hapi 6: Studimet paraprake vlerësuese financiare dhe teknike (1 nentor – 17 nentor)**

Pas vizitave në terren, çdo investimi i bëhet nga specialistet e bashkise një studim vlerësues financiar dhe teknik. Një studim vlerësues përfshin një vlerësim financiar dhe teknik, si dhe një vlerësim të shkurtër mbi ndikimin në ambient dhe mbi ndikimin socio-ekonomik. Administrata e bashkise llogarit koston e përafërt të prioriteteve të infrastruktururës si dhe zhvillon një studim të plotë vlerësues për çdo projekt infrastrukture në listën e prioritetëve.

**7) Hapi 7: Finalizimi i propozimit të Buxhetimit me Pjesëmarrje (20 nentor)**

Këshilli i BP rishikon studimet mbi vlerësimin financiar dhe teknik si dhe përcakton listën finale të prioritetëve të buxhet-propozimit. Në këtë takim delegatët e KBP aprovonin buxhetin final duke votuar me konsensus. Prioritetet finale janë zgjedhur sipas një kriteri të paracaktuar si aksesit tek shërbimet, numri i përfituesve, treguesit e varfërisë dhe vlerësimi i vetë delegatëve gjatë vizitave në terren. Në përfundim anëtarët e Keshillit të Buxhetimit me Pjesëmarrje do të listojnë projektet prioritare dhe me emrgjente për tu implementuar me fondin e caktuar në buxhetin e 2018 –es , per procesin e Buxhetimit me Pjesëmarrjen e komunitetit.

**9) Hapi 9: Aprovimi i propozimit të BP në këshillin lokal ( ne mbledhjen e muajit nentor )**

Buxheti i propozuar më pas i jepet për rishikim kryetarit të bashkisë dhe stafit të tij. Pasi kryetari i bashkisë rishikon buxhetin, Bashkia zhvillon takime të hapura për Bashkinë Roskovec dhe Njiiste Administrative në varesi.

Më pas, finalizohet buxheti dhe dorëzohet për diskutim dhe aprovim në Keshillin Bashkiak.

**Shenim.**

*Çdo dokument , material shkresor dhe foto te arkivohen dhe te behen transparente per publikun periodikisht sipas afateve te mesiperme. Ngarkohet drejtorja juridike dhe e burimeve njezore per venien ne dispozicion per çdo material logjistike te mundshem gjate gjithë procesit. Me kete material te njihen menjere te gjithë subjektet e siperpermendur dhe te publikohet.*

